

VENDIM
Nr. 129, datë 29.7.2016

MBI ANKIMIN ADMINISTRATIV TË OST SHA NDAJ VENDIMIT TË BORDIT TË ERE-s NR. 103, DATË 23.6.2016, "MBI MIRATIMIN E RREGULLORES PËR PROCEDURAT E BLERJES SË ENERGJISË ELEKTRIKE PËR MBULIMIN E HUMBJEVE NË RRJETET E SHPËRNDARJES DHE TË TRANSMETIMIT DHE PËR BLERJEN DHE SHITJEN E ENERGJISË ELEKTRIKE PËR TË SIGURUAR PËRMBUSHJEN E DETYRIMEVE TË SHËRBIMIT PUBLIK"

Në mbështetje të nenit 16, pikat 1 dhe 5, të ligjit nr. 43/2015, "Për sektorin e energjisë elektrike", nenit 16, të "Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s" miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016, Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 29.7.2016, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga drejtoritë teknike mbi kërkesën e OST sh.a., për anulimin e vendimit nr. 103, datë 23.6.2016, "Mbi miratimin e rregullores për procedurat e blerjes së energjisë elektrike për mbulimin e humbjeve në rrjetet e shpërndarjes dhe të transmetimit dhe për blerjen dhe shitjen e energjisë elektrike, për të siguruar përmbushjen e detyrimeve të shërbimit publik",

konstatoi se:

- Shoqëria OST sh.a., me anë të shkresës nr. 4207 prot., datë 17.7.2016, i është drejtuar ERE-s, me një ankim administrativ mbi vendimin nr. 103, datë 23.6.2016 të Bordit të ERE-s.

- Vendimi 103, datë 23.6.2016 i është komunikuar shoqërisë OST sh.a., nëpërmjet shkresës nr. 496 prot., datë 29.6.2016 të ERE-s.

- Mbështetur në nenin 16, pika 5, të ligjit nr. 43/2015, "Për sektorin e energjisë elektrike", si dhe nenin 16, të "Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s", miratuar me vendimin nr. 96, datë 17.6.2016 të Bordit të ERE-s: Për një vendim të Bordit, çdo palë e përfshirë në një procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve pune nga data e marrjes dijeni të vendimit.

- Kërkesa e OST sh.a. për anulimin e vendimit të Bordit të ERE-s nr. 103, datë 23.6.2016 është depozituar në ERE jashtë afateve ligjore.

- OST sh.a. konstaton vështirësi për implementimin e platformës *IT- Online*.

- Bordi i ERE-s, në pikën 2, të vendimit nr. 103, datë 23.6.2016, ka parashikuar se "rregullorja" hyn në fuqi, jo më vonë se 4 muaj nga hyrja në fuqi e këtij vendimi.

- Nuk është paraqitur asnjë provë e re që të çojë Bordin e ERE-s në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga vendimi nr. 103, datë 23.6.2016, i Bordit të ERE-s.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Rrëzimin e kërkesës së shoqërisë OST sh.a. për rishikimin dhe pezullimin e vendimit nr. 103, datë 23.6.2016, "Mbi miratimin e rregullores për procedurat e blerjes së energjisë elektrike për mbulimin e humbjeve në rrjetet e shpërndarjes dhe të transmetimit dhe për blerjen dhe shitjen e energjisë elektrike, për të siguruar përmbushjen e detyrimeve të shërbimit publik".

2. Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumentit të njoftojë shoqërinë OST sh.a. për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit Ahmeti